

PROCEDURA E RINOVIMIT TË LEJEDREJTIMIT PËR HUMBJE TË VLEFSHMËRISË SË SAJ

Afatet e vlefshmërisë së lejedrejtimit në funksion të moshës dhe kategorisë së lejedrejtimit jepen në tabelën si më poshtë.

Moshë (M)	Kategoritë e lejedrejtimit			Kategoritë e lejedrejtimit të posaçme	
	AM, A1, A2, A, B1, B, BE	C1, C1E, C, CE	D1, D1E, D, DE	AM, A1, A2, A, B1, B	C1, C
Deri në 50 vjeç	10 vjet	5 vjet	5 vjet	5 vjet	5 vjet
$50 < M \leq 60$	5 vjet				3 vjet
$60 < M \leq 65$			2 vjet + DAPF *Për C dhe CE vetëm për mjetet deri 20 tonë		3 vjet + çdo 1 vit DAPF (Për taksi)
$65 < M \leq 70$		3 vjet	Ska	Ska	Ska
$70 < M \leq 80$	3 vjet + çdo 1 vit DAPF	Ska	Ska	3 vjet + çdo 1 vit DAPF	Ska

DAPF – Dëshmia e Aftësisë Psikofizike

Drejtuesi i mjetit aplikon për rinovimin e lejedrejtimit, në Drejtorinë Rajonale ku ka vendbanimin, para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së saj.

Nëpunësi i pranimit kontrollon në sistem nëse lejedrejtimi është e vlefshme apo, e pezulluar, bllokuar, etj., me vendim të organeve kompetente.

Për rinovimin e lejedrejtimit, aplikanti plotëson kërkesën për kryerje shërbimi, **model D/KSH** dhe dorëzon:

- dokument identifikimi

Për shtetasit shqiptar, fotokopjen e kartës së identitetit që vërtetohet me origjinalin nga nëpunësi i pranimit.

Për shtetasit e huaj, fotokopje pasaporte e përkthyer dhe noterizuar (rasti kur pasaporta nuk është gjuhë zyrtare e BE) dhe fotokopje leje qëndrimi, të vlefshme, të noterizuar. Për personelin e huaj të Ambasadave ose të Organizatave Ndërkombëtare që gëzojnë statusin diplomatik duhet fotokopja e pasaportës diplomatike, e vlefshme, fotokopje të kartës diplomatike e lëshuar nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe kërkesa për regjistrimin e shtetasit për kryerje shërbimi, e lëshuar nga Ambasada ose nga Organizata Ndërkombëtare.

- certifikatë mjekësore me fotografi, me datë jo më të hershme se 6 muaj nga data e paraqitjes së kërkesës për aplikim;
- lejedrejtimit. Për rastet e humbjes, vjedhjes apo shkatërrimit të lejedrejtimit duhet të dorzojë lejedrejtimitin e përkohshme, ose vërtetimin e denoncimit të policisë. Në mungesë të lejedrejtimit të përkohshme, qytetari aplikon për lejedrejtimi pas përfundimit të afatit prej 30 ditë nga data e lëshimit të vërtetimit të policisë;
- bën pagesën e tarifës së shërbimit për lejedrejtimi prej 3500 lekë;
- fotografohet, bën nënshkrimin elektronik dhe konfirmon personin që do të tërheq lejedrejtimitin;
- kur konfirmon se lejedrejtimitin e tij do ta tërheq një person tjetër dorëzon fotokopjen e kartës së identitetit të këtij personi.

Aplikanti pajiset me kopje përmbledhëse të lejedrejtimit, menjëherë.

Lejedrejtimi tërhiqet pranë DRSHTRR.